

Kompetencat e Rektorit

Sipas nenit 23 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës Rektori kryen funksionet si më poshtë:

- Drejton Senatit Akademik dhe raporton para tij;
- Nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në UST;
- I paraqet Senatit planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
- Paraqet kërkesat akademike, administrative dhe financiare tek Administratori i institucionit të arsimit të lartë;
- Nënshkruan titujt akademikë “*Profesor*” dhe “*Profesor i asociuar*” pas miratimit të tyre;
- Nënshkruan diplomat për të gjitha ciklet e studimeve që ofron UST, pa të drejtë delegimi;
- Trajton ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve dhe u propozon strukturave përkatëse marrjen e vendimeve në lidhje me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Ushtron kontrolle, kryesisht apo me kërkesë të organeve drejtuese të Universitetit, për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, zbatimit të kontratave të punës dhe për çdo veprimtari tjetër që kryejnë fakultetet;
- Ka të drejtën e delegimit të firmës dhe të kompetencave të tij zëvendësrektorëve;
- Miraton strukturën e vitit akademik në shkallë universiteti, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Autorizon, në rast nevojë, hyrjen e forcave të rendit në mjediset e universitetit;
- Shtron për diskutim në rektorat ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve;
- Emëron dhe shkarkon zëvendësrektorët pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatit Akademik;
- Përcakton fushën e veprimit të zëvendësrektorëve dhe bën ndryshimin e tyre kur e gjen të nevojshme për nevoja të institucionit në rastet dhe mënyrën e parashikuar në rregulloren e UST-së;
- Kur e çmon të arsyeshme dhe të nevojshme, ngre grupe pune me qëllim kontrolli, studimi apo veprimtari të tjera të veçanta;
- Kur e çmon të arsyeshme ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit ku mund të paraqesë sugjerime, opinione, rekomandime, me qëllim përmirësimin e punës, orientimin më të mirë në administrimin e institucionit dhe në përputhje me interesin më të lartë të UST-së;
- Nënshkruan marrëveshjet me karakter akademik apo protokollat e bashkëpunimit të universitetit me të tretët, si edhe anëtarësimin në shoqatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Për marrëveshjet për të cilat kërkohet miratimi i Senatit, rektori i nënshkruan ato mbas miratimit paraprak të tij. Në rast se çështjet kanë efekte financiare merret edhe pëlqimi i Bordit të Administrimit;
- Është autoriteti i vetëm kontraktues për anën akademike dhe çështjet protokollare në nivel institucional. Në disa raste, sipas gjykimit të tij, ai mund të delegojë të drejtën e firmës te njëri nga zëvendësrektorët;

- I propozon ministrin përgjegjës për arsimin shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë kryesore të institucionit publik, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së Universitetit. Rektori, brenda dy muajve nga data e shkarkimit, cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit deri në zgjedhjen e autoritetit të ri. Rektori, menjëherë pas shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme, të cilat kryhen brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit;
- Ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë Statut dhe akte të tjera të Universitetit;
- Mbikëqyr zbatimin e vendimeve, masave dhe kërkesave të Senatit Akademik;
- Paraqet propozime për aktet që janë në kompetencë të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit;
- I kërkon informacion Bordit të Administrimit për çështje të kompetencës së tij;
- Kur i kërkohet, merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e organeve dhe të njësisve përbërëse të UST-së në të cilat nuk bën pjesë ligjërisht ose sipas këtij statuti.
- Rektori, në ushtrim të funksioneve të tij, shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime;